



# INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Qendra për Çështjet Europiane dhe të Sigurisë (CESA)

## PASIGURIA E PARALAJMËRUAR

*Tendencat e krimit në Shqipëri 2008 – 2011*

Tiranë, Shtator 2012

Puna kërkimore dhe botimi i këtij raporti u realizua në kuadër të mbështetjes institucionale për IDM nga ana e OSI Think Tank Fund (Fondi për Organizatat Studimore i OSI-t) Budapest - Hungari. mendimet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të OSI Think Tank Fund.

**REDAKTOR PËRGJEGJËS:**

Gjergji Vurmo

**KËSHILLTAR I LARTË:**

Sotiraq Hroni

**PUNA KËRKIMORE & ANALIZA:**

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara ©2012 Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM).

## Përmbajtja

Metodologjia.....	3
Hyrje.....	4
Pasiguria e paralajmëruar: Gjetjet kryesore .....	5
Krime kundër jetës – Mesazhi i fshehur pas “normalitetit” .....	7
Plagosjet në “ekspansion” .....	10
Dhuna e paralajmëruar e “Vjedhjeve” .....	11

## Metodologjia

Aksioni në luftën kundër krimit dhe veçanërisht në parandalimin e shkallës së kriminalitetit në çdo shoqëri bashkëkohore nuk ka për të qenë kurrë i plotë dhe as i qëndrueshëm për aq kohë sa barra dhe përgjegjësia për këtë mision identifikohet ekskluzivisht vetëm me organet e rendit- Policinë e Shtetit. Ky raport dhe analiza e të dhënave mbi figura të veçanta të krimit në Shqipëri synon para së gjithash krijimin e ndjeshmërisë së nevojshme tek politikëbërësit dhe audienca e gjerë e publikut mbi nevojën për një përgjigje më të plotë e më gjithëpërfshirëse ndaj kriminalitetit.

Në funksion të realizimit të objektivit të mësipërm, dhe duke u bazuar pikërisht në këtë kuptueshmëri mbi rolin e aktorëve institucionalë dhe shoqërorë, në fillim të këtij viti IDM ndërmori këtë punë kërkimore për të analizuar tendencat e kriminalitetit në vend dhe nxitjen e debatit publik për alternativat e mundshme për përmirësimin e performancës së institucioneve në luftën kundër krimit dhe parandalimin. Fokusi parësor i këtij studimi u vendos tek statistikat zyrtare mbi vepra të veçanta penale (jo pjesë e kategorive të krimit të organizuar) me ndikim të ndjeshëm në rendin publik apo tek perceptimi publik për të si psh. vjedhje, armëmbajtje pa leje e kanosje, grabitje, vrasje, plagosje etj. Gjithashtu, puna kërkimore dhe analiza u kufizua më tej tek ato figura krimi të cilat përgjatë periudhës 2008 – 2011 ruajnë vijueshmëri në parametrat e regjistrimit në bazën e të dhënave të policisë dhe shfaqen në shifra të konsiderueshme krahasuar me vepra të tjera penale

**Faza e parë** e punës kërkimore konsistoi kryesisht në identifikimin e literaturës bashkëkohore mbi përfaqset e mundshme metodologjike dhe hartimin e metodologjisë së punës kërkimore të IDM duke shqyrtuar eksperiencat dhe studimet e ndryshme mbi kriminalitetin. **Faza e dytë** u zhvillua në kontekstin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPShP) si edhe të komunikimeve të vazhdueshme mes stafit të IDM dhe specialistëve të departamentit përkatës në DPShP për të dhënat mbi figura të veçanta krimi të regjistruara nga organet e policisë. **Faza finale** e kësaj iniciative konsistoi në përpunimin dhe analizën e të dhënave në bazë të kritereve të mësipërme, duke u mbështetur gjithashtu edhe në analizën kërkimore në kohë dhe hapësirë (p.sh. analiza krahasimore mes trendeve të kriminalitetit në Shqipëri me ato të vendeve të rajonit).

## Hyrje

Raportimet e fundit në media mbi pasojat fatale të një serie grabitjesh dhe vjedhjesh me dhunë veçanërisht në kryeqytet kanë rritur ndjeshmërinë dhe vëmendjen e debatit publik mbi sigurinë publike. Raportime të ngjashme, madje mbi krime edhe më të rënda përgjithësisht kanë nxitur debatin publik shpeshherë duke targetuar vetëm policinë e shtetit. Thuajse në asnjë rast kjo ndjeshmëri nuk ka ndikuar në nxitjen e një debati të mirë-informuar mbi politikat e sigurisë publike dhe parandalimit të krimit dhe aq më pak në konkretizimin e alternativave për të adresuar këto sfida nën një përjasje më gjithëpërfshirëse nga pikëpamja e përgjegjësive të institucioneve shtetërore.

Kjo analizë e Qendrës për Çështje Europiane dhe të Sigurisë pranë IDM (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim) synon pikërisht të nxitë dhe të ushqejë debatin jo vetëm institucional me të dhëna konkrete mbi tendencat e krimit në Shqipëri për periudhën katër-vjeçare 2008 – 2011. Studimi synon të krijojë ndjeshmërinë e duhur tek politikëbërësit, institucionet shtetërore të nivelit vendor dhe qendror, rrethet e ekspertizës vendase dhe asaj të huaj në kuadër të misioneve të asistencës, si edhe të partnerëve të vendit të cilët prej vitesh tashmë mbështesin forcimin e kapaciteteve institucionale dhe praktikës së zbatimit të ligjit në Shqipëri.

Analiza e raportit sugjeron se seria e krimeve të rënda të cilat janë shënuar përgjatë 2012 ka qenë prej kohësh e paralajmëruar. Ai gjithashtu tërheq vëmendjen se tendenca e krimit do të vazhdojë të shënojë rritje nëse përgjigjia institucionale nuk bëhet në bazë të një analize të thelluar, nën një perspektive afatgjatë dhe e fokusuar më shumë tek strategjitë parandaluese si alternativë e "goditjes sporadike dhe të paqëndrueshme kundër krimit" nga ana e institucioneve shtetërore.



## Pasiguria e paralajmëruar: Gjetjet kryesore

**Rritja e kriminalitetit** në Shqipëri dhe posaçërisht **pasojat fatale** të tij përgjatë vitit **2012** janë në fakt një **“lajm i paralajmëruar” të paktën prej dy vitesh**. Analiza e këtij raporti studimor të IDM mbi tendencat e (numrit të) veprave të ndryshme penale për periudhën katër vjeçare 2008 – 2011 e konfirmojnë qartazi këtë konstatim.

**Mesatarja e tredeve në rritje** që shënojnë vepra të tilla penale si “Vrasje”, “Plagosje e lehtë me dashje”, “Vjedhje me dhunë” apo “Vjedhje të tjera” në periudhën 2010 – 2011, përveç performancës së dobët institucionale sugjerojnë gjithashtu një **lidhje indirekte me faktorë të tjerë** si – gjendja ekonomike apo klima politike në Shqipëri. Veçanërisht i dukshëm shfaqet **korrelacioni midis rritjes së numrit të këtyre veprave penale prej vitit 2009 e në vazhdim me “situatën politike në vend”** – ku kjo e fundit, nga një situatë paqësore dhe bashkëpunim pozitiv-opozitiv në vitin 2008, është transformuar dukshëm në një krizë tipike politike prej vitit 2010 e në vazhdim. I vetmi **përgjashtim** nga ky korrelacion është vepra penale **“Krime kundër lirisë së personit”** mesatarja e të cilit nga gjysma e dytë e vitit 2010 e në vazhdim është **0.6 vepra penale për tremujor**, ndërkohë që për periudhën **Janar 2008 – Qershor 2010** kjo mesatare ka qenë në shifrat e **12.9 vepra** të tilla penale për tremujor.

Më konkretisht, gjetjet kryesore të cilat drejtpërdrejt sugjerojnë vetë titullin e këtij studimi “Pasiguria e paralajmëruar” përfshijnë:


- “Krimet kundër jetës” (“Vrasje”, “Vrasje nga pakujdesia” dhe “Vrasje në tentativë”) shfaqin një **tendencë të lehtë rritjeje të mesatares vjetore** të këtyre figurave të krimit **në dy vitet e fundit** (2010 – 2011). Numri më i lartë i “Krimeve kundër jetës” përgjithësisht regjistrohet në **tremujorët e dytë dhe të tretë të vitit (periudha “Prill – Shtator”)** dhe pjesa më e madhe e kësaj kategorie (thujse 2/3 e totalit) i përkasin veprës penale të “vrasjes në tentativë”.
- Veçanërisht shqetësuese është **rritja thujse me rreth 40% e numrit të veprave penale “Vrasje” në 2 vitet e fundit (2010 – 2011) krahasuar me periudhën 2008 – 2009**. Statistikat ndërkombëtare për Shqipërinë konfirmojnë një “kërcim” nga niveli i **2.9 dhe 2.7 vrasje për 100.000 banorë për 2008 dhe 2009 respektivisht, në 4 krime të tilla për 100.000 banorë gjatë vitit 2010**. Numri i “vrasjeve” për 100.000 banorë në Shqipëri është ndër më të lartët në rajon. Më konkretisht për periudhën **2008 – 2009 Shqipëria renditet menjëherë pas Malit të Zi** kurse për vitin 2010 ajo ka shifrën më të lartë në të gjithë rajonin.

- Tendenca të dukshme rritjeje (duke filluar prej 2009ës e në vazhdim) shfaq edhe krimi **“Plagosje e lehtë me dashje”**. Numri më i ulët i veprës penale “plagosje” i regjistruar në **tremujorin e parë të vitit 2008 (115 raste)** figuron i **trefishuar në pjesën më të madhe të tremujorëve të 2 viteve të fundit (2010 – 2011)**.
- Thuhetse **80% e totalit të “plagosjeve” përgjatë periudhës 4-vjeçare ka ndodhur në vitet 2009 – 2011 dhe viti 2011 ka shënuar edhe rritjen më të lartë**, me një total “plagosjesh” të regjistruara sa **1/3 e numrit të përgjithshëm** (për të 4 vitet). Vlen të theksohet **korrelacioni midis kurbës së kësaj vepre penale** me tendencat e numrit të regjistruar të krimit **“Armëmbajtje pa leje”** përgjatë 4 viteve të fundit.
- Vepra penale **“Vjedhje lokal tregëtie”** më shumë sesa për tendencën shfaqet interesante për filozofinë e ndërhyrjes nga ana e organeve të rendit. Më konkretisht, **thuhetse pas çdo “piku” të numrit të kësaj vepre penale pason edhe rënia drastike**. Filozofia e **“Përgjegjësi-vetëm-e-Policisë”** nga ana tjetër bën që **pas një fare kohe numri i këtyre veprave penale të rritet sërish, madje me një intensitet më të lartë**.
- Ndryshe nga ndjeshmëria për të vepruar kundër **“Vjedhjeve lokal tregëtie”** reagimi i Policisë është inegzistent në rastin e **“Vjedhje të tjera”** të cilat janë në rritje të pandërprerë prej vitit **2008**. Më konkretisht, të dhënat për numrin e **“Vjedhje të tjera”** në tremujorin e fundit të 2011 krahasuar me tremujorin e fundit të 2008 shënojnë një **rritje prej thuhetse 500%**.
- Së fundi, jo vetëm tendenca e **“Vjedhje të tjera”** por edhe kurba në rritje e vetë veprës penale **“Vjedhje me dhunë”** për këtë periudhë katër vjeçare sugjerojnë se **dhuna fatale** e shënuar në disa raste vjedhjesh gjatë muajve të fundit të 2012ës **ka qenë e paralajmëruar të paktën prej dy vitesh**. **“Vjedhjet me dhunë”** në Shqipëri shfaqin gjithashtu një tendencë në rritje e cila për tremujorë të caktuar kap shifra deri në 100%.

## Krime kundër jetës - Mesazhi i fshehur pas “normalitetit”

Kjo kategori e veprave penale përfshin më konkretisht krimet: a) Vrasje; b) Vrasje nga pakujdesia; c) Vrasje në tentativë. Figura më poshtë shfaq një **tendencë të lehtë rritjeje të mesatares vjetore** të këtyre figurave të krimit **në dy vitet e fundit** (2010 – 2011). Gjithashtu, ajo çka është e përbashkët për të katër vitet e marra në shqyrtim është fakti se **numri më i lartë i “Krimeve kundër jetës” përgjithësisht regjistrohet në tremujorët e dytë dhe të tretë të vitit (periudha “Prill – Shtator”)**. Tendenca e kriminalitetit e paraqitur në Figurën 1. krijon në pamje të parë përshtypjen e një gjendje “normaliteti” të kurbës së krimeve kundër jetës, me diferenca të vogla numerike nga viti në vit.


Figura 1. “Krime kundër jetës në Shqipëri” 2008 - 2011



**Shënim:** Krime kundër jetës përfshijnë a) Vrasje; b) Vrasje nga pakujdesia; c) Vrasje në tentativë.

Pjesa më e madhe e kategorisë “krime kundër jetës” (thuajse 2/3 e totalit) i përkasin veprës penale të “vrasjes në tentativë” luhatjet e të cilës duket se kanë imponuar ndjeshëm tendencat dominuese dhe ngjashmërinë në “normalitetin” e kurbës në Figurën më sipër. Shih Figurën 2 më poshtë.


Figura 2. Vepra Penale “Vrasje e mbetur në tentativë” (2008 – 2011)





E ndërsa “vrasje nga pakujdesia” me një numër të kufizuar (32 të regjistruara) për periudhën 4 vjeçare duket se nuk luan ndonjë peshë në trendet e krimit, ajo që është veçanërisht shqetësuese është **rritja** **thujtë me rreth 40% e numrit të veprave penale “Vrasje” në 2 vitet e fundit (2010 – 2011) krahasuar me periudhën 2008 – 2009**. Është pikërisht kjo vepër penale (më e rënda krahasuar me dy të tjerat e grupit të “Krime kundër jetës”) ajo që jep alarmin në lidhje me kriminalitetin në vend.

**Figura 3. Vepra penale “Vrasje” (2008 – 2011)**



Kjo tendencë rritjeje konfirmohet edhe nga të dhënat e UNODC (United Nations Office on Drugs and Crime) për periudhën 2008 - 2010<sup>1</sup>. Më konkretisht, statistikat për Shqipërinë konfirmojnë një “kërcim” nga niveli i **2.9 dhe 2.7 vrasje për 100.000 banorë për 2008 dhe 2009 respektivisht, në 4 krime të tilla për 100.000 banorë gjatë vitit 2010**. Shih Figurën 4.

**Figura 4. Numri i vrasjeve për 100.000 banorë, Shqipëri 2008 - 2010**



Për të kuptuar më mirë këto shifra është i nevojshëm krahasimi me tendencat e krimit në vende të ngjashme nga pikpamja e parametrave dhe e proceseve zhvillimore nëpër të cilat Shqipëria dhe këto vende kalojnë. Vendet fqinje të Ballkanit perëndimor –

<sup>1</sup> Shih “Intentional homicide, number and rate per 100,000 population” të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit <http://data.un.org/Data.aspx?d=UNODC&f=tableCode%3A1>. Aksesuar në Gusht 2012.

Bosnjë & Hercegovina, Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia<sup>2</sup> - shërbejnë në këtë kuptim si “konteksti” më i përdorur për analiza të tilla krahasimore.

Siç vërehet edhe nga tabela e mëposhtme, **Shqipëria renditet në vendin e dytë – menjëherë pas Serbisë – për nga numri total i vrasjeve për periudhën 2008 – 2010. Numri i “vrasjeve” për 100.000 banorë në Shqipëri është ndër më të lartët në rajon. Më konkretisht për periudhën 2008 – 2009 Shqipëria renditet menjëherë pas Malit të Zi kurse për vitin 2010 ajo ka shifrën më të lartë në të gjithë rajonin.**<sup>3</sup>

**Tabela 1. Shifrat e veprës penale “Vrasje” në vendet e Ballkanit perëndimor**


Shteti	Viti	Numri	Për 100.000 banorë
Shqipëria	2010	127	4
Shqipëria	2009	85	2.7
Shqipëria	2008	93	2.9
Bosnjë Hercegovina	2010	56	1.5
Bosnjë Hercegovina	2009	67	1.8
Bosnjë Hercegovina	2008	66	1.7
Kroacia	2010	62	1.4
Kroacia	2009	49	1.1
Kroacia	2008	71	1.6
Mali i Zi	2009	22	3.5
Mali i Zi	2008	23	3.7
Serbia	2010	123	1.2
Serbia	2009	145	1.5
Serbia	2008	140	1.4
Maqedonia	2010	40	1.9
Maqedonia	2009	36	1.8
Maqedonia	2008	36	1.8

**Pavarësisht numrit në rritje të procedimeve penale për veprën “Armëmbajtje pa leje” (Shih Figurën 5 më poshtë), sidomos duke filluar nga viti 2010 e në vazhdim, institucionet shqiptare duket se do të duhet të rimendojnë strategjitë parandaluese të krimit për të ulur numrin e vrasjeve për 100.000 banorë të paktën në mesataren e rajonit.**

<sup>2</sup> Baza e të dhënave e UNODC nuk disponon statistika për tendencat e krimit në Kosovë.


<sup>3</sup> UNODC nuk disponon të dhëna për këtë vepër penale në Malin e Zi për vitin 2010.

Figura 5. Numri i procedimeve penale për “Armëmbajtje pa leje” (2008 – 2011)



Përveç rritjes së numrit të procedimeve penale për “Armëmbajtje pa leje”, një tjetër **përjashtim** nga tendencat alarmante të figurave të krimit të marra në analizë në këtë raport është vepra penale “**Krime kundër lirisë së personit**”. Siç vërehet nga Figura 6 më poshtë, tendenca (vija e kuqe në grafik) e kësaj vepre penale është dukshëm në rënie. Më konkretisht, mesatarja e këtij krimi nga gjysma e dytë e vitit 2010 e në vazhdim është **0.6 vepra penale për tremujor**, ndërkohë që për periudhën **Janar 2008 – Qershor 2010** kjo mesatare ka qenë në shifrat e **12.9 vepra** të tilla penale për tremujor.


Figura 6. Vepra penale “Krime kundër lirisë së personit” (2008 – 2011)



### Plagosjet në “ekspansion”

Një tjetër vepër penale e cila ka shënuar tendenca të dukshme rritjeje (duke filluar prej 2009ës e në vazhdim) e rrjedhimisht, në mungesë të një strategjie të qartë parandaluese paralajmërojnë të njëjtin trend për 2012 është edhe krimi i “**Plagosje e lehtë me dashje**”. Numri më i ulët i veprës penale “plagosje” i regjistruar në **tremujorin e parë të vitit 2008 (115 raste)** figuron i **trefishuar në pjesën më të madhe të tremujorëve të 2 viteve të fundit**. Shih Figurën 7.

Figura 7. Vepra penale “Plagosje e lehtë me dashje” (2008 – 2011)




Siç vërehet edhe nga Figura 7, thuhet se **80% e totalit të “plagosjeve” përgjatë periudhës 4-vjeçare ka ndodhur në vitet 2009 – 2011**. Viti i fundit i marrë në analizë (2011) ka shënuar edhe **rritjen më të lartë**, me një total “plagosjesh” të regjistruara thuhet se sa **1/3 e numrit të përgjithshëm** për të 4 vitet.

### Dhuna e paralajmëruar e “Vjedhjeve”

Një nga veprat penale, strategjia e parandalimit të të cilave shfaqet veçanërisht problematike janë “Vjedhjet”. Seria e veprave të tilla penale gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 rikonfirmon edhe njëherë se strategjia e institucioneve shtetërore shfaq një deficiencë thelbësore në lidhje me përjashtimin (e munguar) gjithëpërfshirëse ndaj parandalimit të kësaj figure krimi. Për ta materializuar më konkretisht nëpërmjet të dhënave mbi këto vepra penale në katër vitet e fundit, është interesante të analizojmë kurbën e numrit të regjistruar (2008 – 2011) të veprave penale “Vjedhje lokal tregëtie”


Figura 8 (më poshtë) tregon se **thuhet se pas çdo “piku” të numrit të kësaj vepre penale pason edhe rënja drastike**. Kjo duket se është pasojë e fokusimit të organeve të policisë dhe prezencës më të lartë të tyre, e cila gjithsesi nuk mund të mbajë të njëjtin ritëm në vazhdimësi. Mungesa e partneritetit më të gjerë për një përgjigje më të qëndrueshme – me pushtetin vendor apo institucione të tjera – ka ndikuar që **numri i këtyre veprave penale të rritet sërish, madje me një intensitet më të lartë**.

Figura 8. Vepra penale “Vjedhje lokal tregëtie” (2008 – 2011)



E ndërsa ndjeshmëria për sigurinë e operatorëve ekonomikë, ndonëse e paqëndrueshme, gjithsesi ka qenë e lartë pas çdo serie në rritje vjedhjesh, nuk mund të thuhet e njëjtja gjë për të dhënat e kategorizuara nën “Vjedhje të tjera”. Shih figura 9.


Figura 9. Vepra penale “Vjedhje të tjera” (2008 – 2011)



Ndërsa linja e trendit (shih vijën e kuqe në Fig. 9) shfaq qartazi “forcën e krimit”, mbetet ende e pashpjegueshme mungesa totale e vëmendjes nga ana e institucioneve përgjegjëse, madje përballë shifrash të cilat arrijnë deri në **pesëfish për tremujore të caktuara**. Për shembull: të dhënat për numrin e “Vjedhje të tjera” në tremujorin e fundit të 2011 krahasuar me tremujorin e fundit të 2008 shënojnë një rritje prej thuhetse 500%.

Jo më pak alarmante shfaqet situata në lidhje me **tendencat e veprës penale “Vjedhje me dhunë”** përgjatë periudhës së fundit katër vjeçare. Figura 10 dëshmon se **kjo vepër penale ka shfaqur prej kohësh një tendencë rritjeje** me mbi 100% për tremujorë të caktuar. Gjithashtu, prej tremujorit të tretë të vitit 2009, numri i tyre ka qëndruar **mbi nivelin e 30 “Vjedhje me dhunë” për tremujor**.

Figura 10. Vepra penale “Vjedhje me dhunë” (2008 – 2011)



Mungesa e një strategjie të qartë parandaluese si edhe faktorë të tjerë (p.sh. kushtet e vështira ekonomike jo pak të ndikuara edhe nga kriza botërore, politika konfliktuale në vend e cila ndryshe nga viti 2008 në periudhën 2010 - 2011 ka zhvendosur ndjeshëm energjitë e institucioneve) kanë ndikuar në këtë situatë. Analizuar kjo më tej edhe në korrelacion me shifrat në rritje për vepra të tjera penale është e qartë se **dhuna fatale në rastet e vjedhjeve të regjistruara në muajt e fundit ka qenë e paralajmëruar të paktën prej dy vitesh**.